



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	29.12.2017
Referencë	11-344/12
Për :	Kryetar i Komunes- Imri Ahmeti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-DHEJETOR



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT

Pasqyra tabelare e punës për muajin – DHJETOR

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohëshme	Lëndë e ekzekutuara divizione	Inspektime të përbashkëta	Përqime sanitare	Vendosje e shiritav zyrtar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime-ndalesa urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Gjoha mandatore	Inspektim i kafshëve në tregje	Inspektime me polici	Inspektim i tokave bujqësore	Biznese të pajisura dhe na pranime teknike	Mall i pa përshtatshëm për konsum	Të hyrat nga pranimet teknike të lokaleve afariste
Biznesit	265	29	6			19		23	18				8	12	135					15		
Ambientit	209	19		2		1		16	68						99		4					
Bujqësisë	185	19				40			22						70			34				
Ndërtimtarisë	44	8		2				20	10					4								
Trafikut	410	26		3		55		26	28			112	8		47			105				
Sanitar	108	13		3	10	10	4	15	38					3	4		8				33€	
Gjithsejtë	1221	114	6	10	10	125	4	100	184			112	16	19	355		8	109	34	15		

Gjatë muajit Dhjetor, kemi inspektuar bizneset rreth afatshmëris së mallit kushtet e ruajtjes së mallit, çmimet e produkteve ushqimore dhe joushqimore të cilat i kanë ofruar konsumatoreve për konsum, ku kemi bërë krahasimin e çmimeve të vendosura në produkte të ekspozuar me pagesën në arka fiskale dhe kemi konstaurë se ekzistojnë manipulime me çmime të disa maketeve që operojnë brenda Komunës tonë me ç'rast janë marrë masat dhe janë ndëshkuar sipas ligjit për mbrojtjen e konsumatorit 04/L-121.

Njeri prej supermarketeve është ndëshkuar dy herë brenda dy dite pasi që edhe për kundër urdhërësës së dhënë nga inspektorët nuk i kishte harmonizuar çmimet në arkë fiskale. Ky aksion ka filluar prej momentit të shpërndarjes së fletushkave për zbritje çmimesh deri natën e vitit të Ri. Në fund të aksionit janë ndëshkuar katër supermarkete me fletëparaqitje për kundërvajtje. Në kuadër të këtij aksioni është bërë edhe inspektimi në aspektin hijeno-sanitar nga ana e inspektorit Sanitar i cili ka gjetur mall në dy markete ushqimore me afat të skaduar gjë i cili është asgjësuar në vend ngjarje. Ndaj këtyre subjekteve janë marrë masat ligjore me fletëparaqitje për kundërvajtje.

Vëmendje e posaçme gjatë këtij muaji iu kemi kushtuar edhe mbrojtjes së parqeve ku është bërë një fletëparaqitje për një biznes i cili veturën e tij e ka parkuar në pjesën e gjelbëruar. Gjatë vikendit kemi mbajtur kujdestari ku kemi urdhëruar me shkrim kompaninë KUR"Prishtine" për sanimin e disa mbylljeve të kanalizimeve në disa fshatra si Gadime e Epërme, Gllavicë-Marec dhe te tregu i kafshëve. Ku gjatë ditës së fundvitit i kemi zhbllokuar tri fshatrat gjerë në orët e mbrëmjes. Gjithashtu janë inspektuar deponitë ilegale të mbeturinave në qytet dhe rrethinë dhe është inspektuar ambienti në përgjithësi.

Është organizuar aksion në bashkëpunim me Policinë e Kosovës njësisia në Magure në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë për auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale. Nga ky aksion janë konfiskuar dhjetëra automjete me polici ndaj të cilëve janë marrë masat ligjore. Është bërë inspektimi i kompanive të autobusëve të cilët operojnë në këtë territor të Lipjanit se mos ka ndonjë vonesë në rëndë e udhëtimit, si dhe kontrollimi i auto-taksive që janë të parkuar në parkingjet e auto-taksit si në rrugën Lidhja e Prizrenit, Isa Olluri dhe Skënderbeu, se po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari ilegale.

Gjatë këtij muaji janë bërë inspektime mbi tokat Bujqësore në regjione të ndryshme të Komunës ku janë fokusuar ndërrim-destinimet e tokës Bujqësore, është marrur aksion për hapjen e kanalit për ujërat atmosferike në një parcelë në rrugën "Ibrahim Rugova".

Janë inspektuar disa Barnatoret Bujqësore mbi dokumentacionin përkatës për importim dhe distribuim të farërave dhe plehrave sipas ligjeve përkatëse .

Gjatë këtij muaji janë inspektuar disa objekte të ndërtimit si dhe janë inspektuar lokacionet e vend ndërtimeve në terren, gjendja e ndërtimeve është nënë kontrollin e vazhdueshëm inspektues në zonën urbanistike dhe zonat tjera ndërtuese, objekteve pa leje ndërtimi gjatë këtij muaji nuk është identifikuar asnjë objekt. Të gjitha inspektimet e realizuara gjatë këtij muaji në objektet e ndërtimit, rezultojnë të pajisura me Leje ndërtimore, konform Ligjit të Ndërtimit.

Një dukuri shqetësuese gjatë muajit Dhjetor ka qenë pezullimi (hudhja poshtë) e 90 (nëntëdhjetë) fletëparaqitjeve nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan me arsyetimin e vjetërsive të lëndëve mbi një vit.